



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më.....2023

NJOFTIM PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT NË PORTALIN “MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2023.

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 12, datë 27.02.2018 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, të shkresës së MAS nr.1645/5 datë 29.05.2023, “Për realizimin e procedurave të konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2023, njoftojmë fillimin e procedurave sipas afateve të mëposhtme:

- ✓ Kandidati që plotëson kriteret për të ushtruar profesionin e mësuesit, përfshirë parashkollorin dhe dëshiron të marrë pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2023, duhet të regjistrohet online në **platformën <https://mesuespershqiperine.al>**, nga data **15.06.2023 deri në datën 21.06.2023**.
- ✓ Kandidatët të cilët kanë aplikuar online, dorëzojnë një kopje të dosjes së ngarkuar në platformë, pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), në të cilën bën pjesë bashkia e vendbanimit të tyre, nga data **15.06.2023 deri në datën 21.06.2023**.
- ✓ Kandidatët e arsimit parashkollor e dorëzojnë kopjen e dosjes që kanë ngarkuar online pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), të vendbanimit të tyre nga data **15.06.2023 deri në datën 21.06.2023**.

I. Dokumentet e detyrueshme për t’u ngarkuar në platformën e aplikimit online:

- 1) Shtojca 4, e printuar nga sistemi;
- 2) Fotokopje e kartës së identitetit;
- 3) Vërtetim i qendrës së banimit/Certifikatë personale nga e-Albania;
- 4) Kopje e diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë dhe cikli i dytë) ose të barasvlefshme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi;

- 5) Kopje e licensës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- 6) Deklarim nga kandidati për autorizimin e DRAP që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura sipas shtojcës 6, të udhëzimit 12/2021.

Shënim. Dokumentet që ngarkohen në platformën e aplikimit online, janë të skanuara nga origjinali me ngjyra, në rast se nuk ngarkohen online sjellin skualifikimin e aplikantit.

II. Dokumentet që mund të ngarkohen në platformën e aplikimit online nëse kandidati i zotëron dhe kërkon të vlerësohet me pikë për dosjen:

- a. Kopje e librezës së punës;
- b. Kopje e dëshmimeve të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtër”;
- c. Kopje e certifikatave me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit; Certifikatat me kredite të trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MAS, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara;
- d. Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja.

Shënim. Dokumentet që ngarkohen në platformën e aplikimit online, janë të skanuara nga origjinali me ngjyra. Në rast se nuk ngarkohen online nuk sjellin skualifikim, por nuk vlerësohen me pikë.

III. Dokumentet që dorëzohen nga kandidati në momentin e punësimit pranë institucionit arsimor:

- i. Jetëshkrimi;
- ii. Raport mjeko-ligjor;
- iii. Vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore, sipas shtojcës 5, të udhëzimit 12/2021;
- iv. Çdo dokument tjetër që kërkohet sipas kuadrit ligjor në fuqi, në momentin e punësimit.



Shënim. Dokumentet e këtij kreu nuk ngarkohen në platformën e aplikimit online, por dorëzohen në momentin e punësimit.

Kandidati, i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e fundit dhe dëshiron të konkurrojë, duhet të ngarkojë online dosjen, në të kundërt, ai përjashtohet nga konkurrimi. Një kopje të kërkesës për konkurrim, sipas shtojcës 4 të Udhëzimit 12/2021, e printuar vetëm nga sistemi i RASH, kandidati e dorëzon edhe në DRAP-in ku ka qendrën e banimit brenda datës 21.06.2023. Në portal, kandidati zgjedh një nga opsionet:

- a) Aplikoj për herë të parë,
- b) Mbart pikët aktuale (dosje+testim),
- c) Mbart vetëm pikët e dosjes,
- d) Mbart vetëm pikët e testimit.

IV. Afatet e njoftimit të kandidatëve për secilën nga fazat e konkurrimit:

Faza e parë. Verifikimi i kriterëve për kualifikim.

-  Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar shpallin listën paraprake të kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore për kualifikim dhe i njoftojnë në datë 23.06.2023.
-  Kandidatët mund të ankimojnë nëse janë skualifikuar pranë DRAP, brenda datës 24.06.2023.

- ✚ DRAP shqyrton ankesat, harton dhe shpall listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, të cilët futen në testim apo mbartin pikët e portalit të fundit, brenda datës 25.06.2023.
- ✚ Lista e kandidatëve që futen në testim i dërgohet Qendrës së Shërbimeve Arsimore nga DPAP, në datë 26.06.2023 dhe më tej kandidatët ndjekin publikimin e datave për testim në faqen zyrtare të QSHA-së, <http://qsha.gov.al/>.

Faza e dytë. Vlerësimi i dosjeve të kandidatëve.

- ❖ DRAP njofton kandidatët për vlerësimin me pikë të dosjes së tyre dhe publikon në faqen zyrtare të saj listën paraprake, në datë 10.07.2023.
- ❖ Kandidatët mund të ankimojnë pranë DRAP vlerësimin me pikë të dosjeve nga data 10.07.2023-14.07.2023.
- ❖ DRAP shqyrton ankesat, harton dhe shpall listën përfundimtare me pikët e dosjeve të kandidatëve të kualifikuar në datë 20.07.2023.

Faza e tretë.

Pas përfundimit të testimit të informatizuar dhe dërgimit të listës përfundimtare nga QSHA, në platformën <https://mesuespershqiperine.al> dhe faqet zyrtare të instucioneve përkatëse, shpallet lista e kandidatëve pjesëmarrës me pikët e dosjeve dhe pikët e testimit të informatizuar.

Vendi aplikimit:

- ✓ Kandidatët për konkurrim apo pjesë e listës së portalit “Mësues për Shqipërinë” 2023 aplikojnë online në linkun <https://mesuespershqiperine.al/Account/Login> nga data 15.06.2023-21.06.2023;
- ✓ Dosja fizike e dokumentave, kopje e ngarkuar në platformën online brenda afatit të mësipërm dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në Drejtoritë Rajonale për mësuesit e AF, AMU, AML dhe pranë ZVAP-së për kandidatët e arsimit parashkollor, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur.

Aneksi nr.1 Ndarja territoriale

I. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

(Adresa: Lagjia Nr.13, Rruga “Egnatia” Kutia Postare 2001, Durrës)

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	Bashkia
Dibër	Dibër
Krujë	Krujë
Kamëz	Kamëz
Tiranë	Tiranë
Durrës	Durrës
Bulqizë	Bulqizë
Mat	Mat
Klos	Klos
Shijak	Shijak
Kavajë	Kavajë
Vorë	Vorë
Rrogozhinë	Rrogozhinë

II. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

(Adresa: Sheshi “Gjergj Kastrioti”, kati 2, godina OKF “Gjergj Lacaj”, Lezhë)

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	Bashkia
Has	Has
Tropojë	Tropojë
Mirditë	Mirditë
Malësi e Madhe	Malësi e Madhe
Vau Dejës	VauDejës
Pukë – Fushë Arrëz	Pukë – Fushë Arrëz
Kukës	Kukës
Lezhë	Lezhë
Kurbin	Kurbin
Shkodër	Shkodër

III. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË

(Adresa: Lagjia 18, Rruga “Dhimitër Denasi” 7001, Korçë)

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	Bashkia
Dimal	Dimal
Kuçovë	Kuçovë
Cërrik	Cërrik
Belsh	Belsh
Peqin	Peqin
Gramsh	Gramsh
Librazhd	Librazhd
Përrenjas	Përrenjas
Maliq	Maliq
Kolonjë	Kolonjë
Berat	Berat
Korçë - Pustec	Korçë - Pustec
Devoll	Devoll
Pogradec	Pogradec
Elbasan	Elbasan
Skrapar	Skrapar
Poliçan	Poliçan

IV. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

(Adresa: Lagjia “Kastriot”, Rruga “Leon Rei”, Fier)

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar	Bashkia
Patos	Patos
Roskovec	Roskovec
Divjakë	Divjakë
Mallakastër	Mallakastër
Selenicë	Selenicë
Finiq-Dropull	Finiq-Dropull
Tepelenë - Memaliaj	Tepelenë - Memaliaj
Përmet - Këlcyrë	Përmet - Këlcyrë
Sarandë - Konispol - Delvinë	Sarandë - Konispol - Delvinë
Lushnje	Lushnje
Vlorë - Himarë	Vlorë - Himarë
Fier	Fier
Gjirokastër - Libohovë	Gjirokastër - Libohovë